



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**ZL.Anr.225/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Afijete Sada-Glllogjani dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.10.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me shenjen ZL.Anr.225/2017 e datës 16.10.2017, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet.

### **A r s y e t i m**

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 16.10.2017, me të cilën pretendon se kandidati për kryetar të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik PDK, Shaqir Totaj, në spotin e tij në facebook, ka përfshirë zyrtaren e ATK-së, Elizabeta Kabashi e cila bënë fushatë për kandidatin e PDK-së, pretendohet se subjekti në fjalë ka shkelur nenin 35 pika 2 e LZP-së dhe nenin 5.2 të Rregulles Zgjedhore 13/2013.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një CD, lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në përgjigjen në ankesë të datës 17.10.2017, ka theksuar se ankesa e organizatës BIRN dhe IKS, është e pabazuar dhe nuk përmban shkelje të Rregullave Zgjedhore, duke theksuar se sekuencat e shfaqura në spotin e kandidatit për kryetar të Komunës së Prizrenit për arsye se Elizabeta Kabashi personi që është përfshirë në fushatë nuk mban poste udhëheqës ose menaxhuese në ATK . Gjithashtu, PDK ka theksuar se personi në fjalë nuk mban post as udhëheqës e as menaxhues në ATK poste të cilat me Ligjin për Shërbyesit Civil kërkojnë të jenë apolitike.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e pa bazuar**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës BIRN dhe IKS, lidhur me shkeljet e pretenduara të Rregullave Zgjedhore, nga ana e subjektit politike PDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Rregullave Zgjedhore, pasi që personi në fjalë nuk mban post udhëheqës apo menaxhues në ATK, prandaj ky veprim nuk bie ndesh me Rregullen Zgjedhore 13/2013 të nenit 5.2 i cili nen përcakton qartë se: “në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen kategoritë e të punësuarve në; Institucionet shtetërore dhe publike, forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK), Policia e Kosovës dhe personeli i tyre, organizatat bamirëse dhe fetare, përfaqësuesit e bashkësive fetare, KQZ-ja, Sekretariati i KQZ-së dhe Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe përfaqësuesit e organizatave të mjeteve të informimit masiv, kur ata janë të angazhuar në aktivitetet e tyre profesionale si dhe personat të cilët nuk kanë mbushur 18 vjet në ditën e zgjedhjeve”. Prandaj Paneli bazuar në nenin 117 par 2 si dhe duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë dhe në kuptim të nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Zl.Anr.225/2017 më datë 18.10.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
Gjytene Sylejmani

***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.